



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES, RISHIKUES TEZE,
KORRIGJUES DHE RIKORRIGJUES TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE**

Njoftohen të gjithë të interesuarit për të aplikuar si hartues, rishikues teze, korrigjues dhe rikorrigjues, për provimet e aftësive profesionale në disipinat si më poshtë vijon:

1. *“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”- 20 Maj 2023;*
2. *“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare”- 03 Qershor 2023;*
3. *“Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”- 10 Qershor 2023;*
4. *“Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”- 24 Qershor 2023;*
5. *“Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”- 01 Korrik 2023;*
6. *“Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”- 08 Korrik 2023.*

Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit janë si më poshtë:

Hartuesit dhe hartuesit rishikues duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Si dhe përvec pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatës profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Kriteret që duhet të plotësojnë korrigjuesit janë si më poshtë:

Korrigjuesit dhe korrigjuesit rishikues duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- iii. Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatës profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Çdo kandidat që aplikon për hartues, rishikues teze, korrigjues dhe rikorrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:

- a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
- b. Curriculum Vitae;
- c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
- d. Fotokopje të diplomave;
- e. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

**Të gjithë kandidatët do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.*

Shënim*

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues, rishikues teze, korrigjues dhe rikorrigjues për provimin e aftësive profesionale është deri më **datë 5 Maj 2023 ora 14:00**.